

DEKLARATË

Procesi i regjistrimit të kandidatëve, po ngre pikëpyetje mbi integritetin e procesit të ardhshëm zgjedhor

Më datën 6 maj KRIIK nëpërmjet një Deklarate i bëri thirrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) që në frymën e kushtetutës dhe ligjit **të marrë rol proaktiv në sigurimin e integritetit të të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor**¹. Një rol ky më se i domosdoshëm në kushtet e një krize politike në rritje dhe të përgatitjes së një procesi zgjedhor me trupa administrimi të ndërtuara politikisht në mënyrë të njëanshme.

Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) në zgjedhjet vendore marrin një rol akoma më të rëndësishëm pasi ato kryejnë regjistrimin e kandidatëve dhe shpalljen e kryetarit të bashkisë në 51 bashkitë e vendit të cilat përputhen në shtrirje territoriale me atë të vetëm një ZAZ-je, ndërkohë që për 10 bashkitë e tjera regjistrimi dhe shpallja bëhet nga KQZ-ja².

Data 13 Maj 2019 ishte afati për regjistrimin e kandidatëve për t'u zgjedhur në organet e pushtetit vendor për katërvjeçarin e ardhshëm, si kryetarë të bashkive dhe anëtarë të këshillave Bashkiakë, të propozuar nga partitë politike të regjistruara tashmë në zgjedhjet e ardhshme.

Në vazhdimësi të ndjekjes së ecurisë së procesit zgjedhor dhe nga kontaktet e marra me një pjesë të konsiderueshme të KZAZ-ve, KRIIK **konstaton me shqetësim se ka paqartësi**, qoftë nga organet e administrimit zgjedhor të nivelit të dytë qoftë edhe nga aktorë të tjerë institucionalë e politikë, **lidhur me procedurën e regjistrimit të kandidatëve**³.

Kodi Zgjedhor parashikon se kandidatët e propozuar nga partitë politike që nuk kanë prej 6 muajsh asnjë mandat në kuvend apo në këshillin bashkiak ku bëhet regjistrimi, duhet të mbështeten nga lista me firma mbështetëse⁴. Dokumentet e kandidimit duhet të dorëzohen të gjitha njëherazi në afatin e përcaktuar⁵, ndërkohë që ligji jep mundësinë edhe të plotësimit të mangësive në përmbajtje të dokumentacionit, por pas marrjes në shqyrtim dhe me vendim të komisionit administrues përkatës⁶.

Në mbledhjen e tij të datës 16.05.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë Lezhë, z. Eduart Ndocaj të propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe kontaktet e marra, KRIIK **konstaton se ky vendim është marrë në shkelje të ligjit dhe procedurave të parashikuara**. Dokumentat që zëvendësojnë listën me firma mbështetëse ndaj kandidaturës së z. Ndocaj, konkretisht vërtetimi i lëshuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe ai i lëshuar nga Këshilli i Bashkisë Lezhë, **janë të pasaktë**.

Në vërtetimin e lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë me Nr. 13 Prot datë 13.05.2019 thuhet se Deputeti Kujtim Gjuzi, i cili ka bërë betimin si deputet më datë 08.05.2019, është deklaruar se përfaqëson subjektin "Partia Kombëtare Konservatore Albania".

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Gjithashtu vërtetimi citon se “Ai zotëron mandatin e deputetit të paktën 6 muajt e fundit, sipas parashikimeve në Kodin Zgjedhor”, çka **nuk është e vërtetë, pasi mandati 6 mujor i deputetit, nëse do t’i referoheshim datës së zgjedhjeve apo afatit të regjistrimit të kandidatëve**⁷, do të duhej të zotërohej prej z. Gjuzi së paku prej datës 30.12.2018⁸, nwse.

Ndërsa në vërtetimin e lëshuar prej Këshillit të Bashkisë Lezhë me Nr. 4751/1 Prot datë 13.05.2019, thuhet se “mbështetur në vendimin Nr. 161 datë 03.07.2017 të Këshillit Bashkiak Lezhë⁹, vërtetojmë se z. Petrit Ndreu është anëtar i Këshillit Bashkiak Lezhë, i propozuar nga subjekti politik, PKKA (Partia Kombëtare Konservatore Albania)”. Kjo është e pasaktë pasi z. Ndreu është zgjedhur si anëtar i Këshillit Bashkiak Lezhë, i propozuar nga subjekti politik Partia Konservatore (KONS)¹⁰, **e cila është një subjekt i ndryshëm elektoral nga Partia Kombëtare Konservatore Albania (PKKA)** apo ish-Partia Forca Albania¹¹. Nga ana tjetër nga kontaktet e marra, konstatohet se z. Ndreu **nuk ka bërë ndonjë deklaratë me shkrim të depozituar tek sekretari i Këshillit Bashkiak Lezhë, 6 muaj më parë** ku të deklarojë përkatësinë e tij tashmë tek subjekti tjetër elektoral PKKA.

KRIIK gjithashtu vëren se **ka paqartësi mbi procedurat e kriteret edhe nga subjektet politike**. Përpos subjektit “Partia Kombëtare Konservatore Shqiptare”, evidentohet edhe subjekti “Bindja Demokratike” e cila ka dorëzuar dokumentet e aplikimit të kandidatëve në disa KZAZ¹², pa i mbështetur me lista me firma mbështetëse, por i mbështet me një vërtetim nga Kuvendi i Shqipërisë ku Deputeti Andi Përmeti, i cili ka bërë betimin si deputet më datë 25.04.2019, është deklaruar se përfaqëson subjektin “Bindja Demokratike”.

Në këto kushte **KRIIK i bën thirrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të rimarrë në shqyrtim dhe të vendosë në shina ligjore regjistrimin e z. Ndocaj si dhe, në mënyrë urgjente, të marrë masat e duhura për të mbikqyrur sa më nga afër dhe me kujdes të gjithë procesin e regjistrimit të kandidatëve**, veçanërisht nga Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor.

Gjithashtu, KRIIK i sugjeron KQZ-së që nëpërmjet një thirrje publike apo edhe nëpërmjet kanaleve të tjera të komunikimit të informojë në mënyrë të plotë dhe të qartë procedurat dhe kriteret që duhet të zbatohen në regjistrimin e kandidatëve, si për KZAZ-të ashtu edhe për aktorët e tjerë apo publikun e gjërë.

KRIIK i bën thirrje **Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë të jetë i kujdesshëm në zbatimin e duhur të frymës dhe gërmës së ligjit**. Kodi Zgjedhor përcakton qartë se asnjë prej mandateteve individuale të deputetëve të rinj zëvendësues nuk mund të përdoret për të zëvendësuar listën me firma mbështetëse për asnjë subjekt zgjedhor.

Gjithashtu, iu bën thirrje Kryetarëve të Këshillave Bashkiakë që të përmbyllin me integritet dhe korrektësi mandatin dhe detyrën e tyre duke zbatuar më përpikmëri kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe të legjislationit në fuqi.

Në përfundim, KRIIK sjell në vëmendje se procesi i përzgjedhjes dhe regjistrimit të kandidatëve mbetet një proces thelbësor për qeverisjen vendore, veçanërisht në pikëpamje të cilësisë së kandidatëve, integritetit dhe moralit që ata manifestojnë e

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

përcjellin, si dhe të mënyrës së përzgjedhjes së tyre, elementë këto që janë aktualisht veç ekskluzivitet i vullnetit politik dhe dëshirave të partive politike. Respektimi i afateve, procedurave dhe kërkesave të ligjit prej këtyre të fundit dhe kandidatëve të tyre **mbetet ndërkohë detyrim primar e i padiskutueshëm, por njëkohësisht edhe shumë domethënës.**

Tiranë, më 17 Maj 2019!

¹ KRIIK, [Deklaratë](#) "Ruajtja e paanësisë dhe integritetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rëndësi jetike për funksionimin e shtetit demokratik e ligjor", datë 06.05.2019.

² Bashkitë: Shkodër, Lezhë, Durrës, Kamëz, Tiranë, Elbasan, Lushnjë, Fier, Korçë dhe Vlorë.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 67 "Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive", pika 1 "... Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohesh në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve", dhe pika "3. Në zbatim të paragrafit të dytë, të pikës 1, dhe të paragrafit të dytë, të pikës 2, të këtij neni, kandidati për kryetar bashkie dhe listat për këshillin e bashkisë, territori i të cilave nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, regjistrohesh në KQZ".

³ Sipas informacioneve të marra pranë KZAZ-ve, KQZ ka rekomanduar të evitohet vendimmarrja në lidhje me regjistrimin e kandidatëve deri në marrjen e një autorizimi nga KQZ-ja, duke qenë se kjo e fundit po verifikon formularët e dekriminalizimit të kandidatëve. Ndërkohë disa KZAZ iu kanë kthyer dokumentacionin e paraqitur nga disa subjekteve pasi janë verifikuar mangësi.

⁴ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 68 "Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve", pika: "2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit", dhe pika "3. Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit".

⁵ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 72 "Dokumentet e kandidimit", pika "1. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e këtij Kodi dhe sipas formës së përcaktuar në udhëzimet e KQZ-së".

⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 73 "Verifikimi i dokumentacionit", pika "1. KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vëren parregullsi apo mospërbushje të kërkesave të këtij Kodi, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve".

⁷ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Diskutimet e zhvilluara në interpretim të kësaj dispozite me synim adresimin në Vendimin Nr. 44, datë 17.02.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi Nr. 284, datë 05.05.2017 "Për miratimin e listave shumëvokale të Partisë "Lista e Barabartë" për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017", duke u bazuar në listën mbështetëse të 9140 nënshkrimeve të vlefshme, ndërkohë që Partia "Lista e Barabartë" (Libra) zotëronte 2 mandate deputetësh në Kuvendin e Shqipërisë, përkatësisht nga Znj. Mimoza Hafizi dhe z. Ben Blushi, por që ishte regjistruar në Gjykatën e Tiranës më datë 25.11.2016.

Gazeta Panorama "[Udhëzimi i fshehtë i KQZ-së për zgjedhjet/ Hafizi: Cënon vetëm LIBRA-n](#)", datë 16.02.2017.

⁸ Nëse do të merrej si referencë data e zgjedhjeve.

⁹ Këshilli Bashkiak Lezhë, [Vendimi Nr. 161](#), datë 03.07.2017 "Per mbarim para afatit te mandatit te keshilltarit dhe dhenie mandatit keshilltarit nga krijimi i vendeve vakant".

¹⁰ Depozituar vendimi i Kongresit të Tretë të Partisë Konservatore, Regjistruar me Vendimin Nr. 2068 datë 15.03.2017 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kryetar z. Armando Ruço (ndryshimet e fundit në regjistrë).

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Regjistruar si subjekt elektoral në Zgjedhjet Vendore 2015 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin Nr.140 datë 14.04.2015 “Për regjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë, “Partia Konservatore”, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015”.

“Partia Konservatore” rezulton se është regjistruar fillimisht me emrin “Partia Kombëtare e Legalitetit” me urdhërin nr. 11/1 datë 21.09.1995 të Ministrit të Drejtësisë, më pas me urdhërin Nr. 11/1 datë 09.09.1996 është bërë ndryshimi i emrit në “Partia Kombëtare Konservatore Shqiptare” dhe me vendimin Nr. 1846 datë 21.05.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është bërë ndryshimi i emrit në “Partia Konservatore” me sigël “KONS” dhe Kryetar të saj, z. Armando Ruço.

¹¹ Partia “Forca Albania”, themeluar më datë 02.11.1999 është regjistruar me Vendimin Nr. 1935 datë 14.06.2000 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke patur si Kryetar z. Iledin Pillati. Me Vendimin Nr. 13134 Akti dhe Nr. 8826 datë 04.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është bërë “Depozitimi i vendimeve të Kongresit të Partisë Forca Albania mbajtur më 24.09.2016. Sipas Vendimit të Gjykatës së Tiranës me Nr. 374 Regj. Themeltar, të marrë më datë 20.02.2017, vendim i cili bën sqarimin dhe interpretimin e Vendimit Nr. 13134 Regj. Themeltar Nr. 8826 datë 04.11.2016, dhe që i bashkangjitet këtij të fundit, qartësohet se është bërë ndër të tjera ndërrimi i emrit të Partisë në “Partia Kombëtare Konservatore Albania” (shkronja nistore “PKKA”) si dhe është zgjedhur Kryetar z. Kujtim Gjuzi.

¹² Në Bashkitë Tropojë, Bulqizë dhe Tepelenë.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania